



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 2574/24 Datë: 18/12.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 132 të mbajtur më 09 dhe 10.12.2024, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet Fakulteti i Studimeve Islame në nivel institucional, për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028).
- II.** Obligohet Fakulteti i Studimeve Islame që deri me 30 shtator, të dorëzojnë në AKA planin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakulteti i Studimeve Islame ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1478/24, datë 30.07.2024, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 21.11.2024, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Melita Kovacevic, Magdalena Platis dhe Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe në Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të

Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit duke konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Fakulteti i Studimeve Islame është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht pesë (5) standarde;
- Substancialisht pesë (5) standarde dhe
- Pjesërisht një (1) standard të akreditimit.

Duke ju referuar standardeve të plotësuara Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka rekomanduar që Fakulteti i Studimeve Islame të riakreditohet për periudhën tre (3) vjeçare, nga 1 tetor 2025 deri me 30 shtator 2028.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 132-të, të mbajtur më 09 dhe 10.12.2024 ka shqyrtuar kërkesën e Fakulteti i Studimeve Islame dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi ju dërgohet :

- Fakulteti i Studimeve Islame;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.